



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
Njësia e Prokurimit

Data 31.01.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Blerje karburanti per nevoja te mjeteve motorrike dhe ngrohjen e shkollave te bashkise Has gjate vitit 2023"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Karburante-09100000-0, Naftë-09134000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,100,000 (Gjashtëmilion e njëqind mijë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit **Nr.** 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia HAS ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari i Ofertës sipas Shtojcës 1*
- b. *Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit sipas Shtojcës 2;*
- c. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- d. *Lista e Informacionit Konfidencial: Shtojca 4;*
- e. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 8;*
- ë) *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 16 (Konfidencialiteti), 76 (Kriteret detyruese për skualifikim), 82 (Formulari përmbledhës i vetdeklarimit) dhe 83 (Sigurimi i ofertës) të LPP, nenit 26 (Formulari përmbledhës i vetdeklarimit), nent 30 (Sigurimi i ofertës) të VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Këto kritere janë vendosur për të vërtetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kritere janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

a. Sipas përcaktimeve të bera në Shtojcën 7 të ketyre DST (Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit) pikat: 1&2. Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe 8 (formulari përmbledhës i vetëdeklarimit).

b. Të paraqitet leja përkatëse për lejimin e tregtimit të karburanteve sipas objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 (*Kërkesat për kualifikim*), pika 1/a dhe 2, të **LPP**, nenit 40, pika 5, të VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe Mbeshtetur në ligjin **Nr.** 8450 date 24/02/1999, "Per perpunimin, transportimin e naftes dhe nenprodukteve të tjera", i ndryshuar. VKM **Nr.** 970, datë 2.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" **Keto kritere vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.**

(Shënim: përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2019,2020,2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të prokuruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77(*Kërkesat për kualifikim*), pika 3 (...entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar), e **LPP**, si dhe nenin 43 (*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*), të VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 55 (*Procedurë e hapur e thjeshtuar*); "Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalohet: 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave". Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43 (*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*), pika 2, germa c), për procedurat në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021, "Për rregullat e prokurimit publik", e cila parashikon se Autoriteti koonraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare (*Neni 43, pika "1"*). Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor (*Neni 43, pika "4"*).

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjit **Nr.** 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave **Nr.** 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe VKM-së **Nr.** 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike"

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit **Nr.** 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", Ligjin **Nr.** 25/2018 datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", të Ligjit **Nr.** 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (*Neni 57*), Ligjit **Nr.** 10091 datë 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, si dhe VKM-së **Nr.** 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike"

Kërkesa për shlyerjen e detyrimeve vendore i referohet kërkesave specifike të Ligjit **Nr.** 9632 datë 30.10.2006, "Per Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2020, 2021, të paraqitur në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet, me nenshkrim dhe vule (shëno bazën ligjore:), ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2020, 2021, të paraqitur në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet, me nenshkrim dhe vule + Raporti i Auditimit të Pavarur (duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit **Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "nenit 41 -Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël"). Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit". Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 (Kërkesat për kualifikim), pika 3 (...autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.), e **LPP**, si dhe nenit 43(Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare), pika 4 (autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare), të VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit **Nr.** 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, si dhe VKM-së **Nr.** 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese).

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se subjekti ofertues ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2018, 2019, 2020 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij, (Referuar ekstraktit të thjeshtë dhe historik të operatorit ekonomik lëshuar nga QKB. (Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit që tregon kryerjen e detyrimeve taksave dhe tarifave vendore, është bërë referuar ligjit **Nr.** 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij, (Referuar ekstraktit të thjeshtë dhe historik të operatorit ekonomik lëshuar nga QKB).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë **vërtetime të lëshuara** nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit **Nr.** 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave

të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Të paraqiten raport analizat për mallrat që kerkohen ku të përfshihen të gjithë treguesit e përcaktuar në specifikimet teknike.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në zbatim të nenit 77, të Ligjit **Nr.** 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 40, pika 6, gërma ”c” (... *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare...*) e VKM-së **Nr.** 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 22 dhe 23 Ligjit **Nr.** 8450, datë 24.02.199 “Për përpunimin, transportimin e naftës dhe nënprodukteve të tjera” i ndryshuar, VKM-së **Nr.** 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel” pasi Autoriteti Kontraktor kërkon të garantohet që karakteristikat teknike të mallit të ofruar të përputhen me standartet teknike të kërkuara nga autoriteti Kontraktor. Pra me qëllim që të përcaktohet në mënyrë të qartë cilësia e mallrave me anë të një raport analize me qëllim për të vërtetuar që karburanti të jet brenda standarteve sipas ligjit për hidrokarburet .

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme ose Autorizim për tregtim karburantesh të llojit III/A¹ (Gazoil), siç përcaktohet në VKM-në me **Nr.** 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit **Nr.** 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 (*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*, gërma a,) *licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;*), të VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM-në me **Nr.** 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në zbatim të nenit 40, pika 5, gërma ”a” e VKM – së **Nr.** 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pikës 2 dhe 3 të nenit 20 Ligjit **Nr.** 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin e naftës dhe nënprodukteve të tjera” i ndryshuar, VKM – së **Nr.** 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Dhënia e licencës për tregtim me pakicë së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikantë dhe të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë si dhe për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, bëhet nga organet e qeverisjes vendore.

¹Neni 10, LIGJI Nr.8450, datë 24.2.1999, ndryshuar

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

4. Të paraqitet dokumentacion për të vertetuar që:

Aktiviteti i vëmprimitarië për pikën e karburantit duhet të jetë brenda territorit bashkisw Has, gjë për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë apo marrjes me qira.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit **Nr.** 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenet 40, pika 5 (*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*, të VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kriter i cili vendoset me qëllim për ti favorizuar mjetet e rënda teknologjike si dhe mjetet e bashkisë të mos nevojitet të përshkojnë distanca të largëta rrugë jashtë territorit të Bashkisë dhe të mos kemi kosto karburanti nëse mjetet e bashkisw do të furnizohen në një pikë karburanti me distancë të largë nga Bashkia.

5. Formularin e Ofertës i cili duhet të përmbajë vlerën totale të ofertës pa TVSH dhe me TVSH si dhe elementët e përlllogaritjes së saj.

Shënim : Operatorit ekonomik do të ofertojnë për mallin objekt prokurimi me çmim.

Argumentim: Mbështetur në nenin 45 (*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*), pika 2.1 (*Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në*) të VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, **ku përcaktohet se:**

Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në:

- a. *Çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF- Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;*
- b. *Elementët fiskal;*
- c. *Normën e fitimit e shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshueshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.*

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Operatori/et Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera 1 (një) autobus të posaçëm për transport të lëndëve të rrezikshme së bashku me aparatën matës. Autoboti do të shërbejë për transportin e karburantit në vendin ku ndodhen depozitat (kryesisht kaldaja të shkollave) dhe mjetet e tonazhit të rëndë të autoritetit kontraktor. Autoboti duhet të jetë i pajisur me Leje Qarkullimi (në rastet kur janë në pronësi) ose kontratën e vlefshme të qerave + leje qarkullimi (në rastet e marrjes me qera) si dhe Çertifikatën e Kontrollit Teknik, siguracionin e mjetit dhe pasaportën e mjetit. Për arsye të vendodhjes së depozitave (kryesisht kaldaja të shkollave) dhe mjeteve të tonazhit të rëndë të autoritetit kontraktor dhe vështirësisë në rastet e furnizimit autoboti duhet të ketë vëllim 1000 (njemijë)-2000 (dymijë) litra.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 (*Kërkesat për kualifikim*), të ligjit **Nr.** 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 (*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*), pika 5/ç (*mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*), të VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës).

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1. Specifikime teknike GAZOIL D1 (Eurodizel).

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërish çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

SPECIFIKIME TEKNIKE GAZOIL D1 (Eurodizel)

Te dhenat teknike te Gazoil D1 (Eurodizel) i referohen standardit europian (EN) te adoptuara nga Drejtoria e Pergjitheshme e Standartizimit dhe qe ka statusin e standardit shqiptar (S SH).

Specifikimet teknike per realizimin e kontrates jane: gazoil D1

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Normat e lejuara	
		minimale	maksimale
Densiteti në 20 °C ne 15°C	kg/m ³	820	840 860
Ngjyra	LB	0.003	0.01
Indeksi i cetanit			45
Përmbajtja e squfurit	%	-	0.01
Pika e flakërimit	55°C	55	62
Përmbajtja e koksit (në 10 % mbetje distilimi)	% (m/m)	-	0,30
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,01
Përmbajtja e ujit	ppm	-	200
Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	vlerësim		klasa 1 A
Stabiliteti ndaj oksidimit	g/m ³	-	25
Viskoziteti kinematic në 20 °C	(cSt)	3	6
Distilimi distilati që vlon ÷ në 250°C,%(v/v)	% (V/V)		< 65
distilati që vlon ÷ në 350 °C,%(v/v)	% (V/V)		
distilati që vlon në 95 % (v/v)	°C	85	360
Aciditeti total	mgKOH/100 ml		0.5

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Argumentim: Specifikimet teknike për mallra objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elemnetëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 të LPP – së si dhe nenit 40, pika 2 e VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Anëtarët pranuan specifikimet teknike të hartuara nga Komisioni i posacëm: **KLLFLST (Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike)** i ngritur me urdhër të titullarit

të Autoritetit Kontrakt, duke konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për mallin që do të blejë.

Argumentimi: Preventivat janë hartuar nga specialistet e fushes konkretisht nga KLLFLST, dorëzuar preventivat dhe shprehin qarte kerkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e mall-it/ rave. Komisioni për hartimin e preventivit është bazuar në studimin tregut dhe të dhënat për karburantet marrë nga Buletini i PP, janë marrë nga bursa “PLATTS” e datës 20,23,24,25,26 Janar 2023(Buletini APP NR 10, Datë 30-01-2023) .

PREVENTIV:

“Blereje karburanti për nevojat e Bashkisë (Mjete+Kaldaje)”

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Nafte D1	litra	38,000
	Shuma		
	TVSH 20%		
	TOTALI		

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do të paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për tu firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

Afatet e lëvrimit: Afatet e lëvrimit: sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor në mënyrë periodike deri më 31.12.2023.

NJËSIA E PROKURIMIT: